



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-CC-2017-02

Vendosi: **Kryetarja e Dhomave të Specializuara**
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 12 prill 2017

Titulli: Kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës së
Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në shtetin pranues

Publik

**Vendim në lidhje me vendin e zhvillimit të procedurës së Dhomës së
Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e Rregullores së Procedurës
dhe të Provave, në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit**

Autoriteti kërkues:

Kryetarja e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), pasi ka marrë një kërkesë nga Kryetarja e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“DHSGJK”) për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pranues, në vijim dhe në përputhje me nenin 3(8)(d) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), merr vendim në lidhje me vendin e zhvillimit të procedurës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), në bazë të nenit 19(5) të Ligjit.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 1 janar 2017, hyri në fuqi *Marrëveshja midis Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Kosovë për Vendosjen e Institucionit Gjyqësor të Specializuar të Zhvendosur të Kosovës në Holandë* (“Marrëveshja me Shtetin Pranues”).
2. Më 17 mars 2017, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të mbledhur në seancë plenare (“Plenare”), me përjashtim të gjykatësve të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, miratuan Rregulloren.
3. Më 27 mars 2017, Kryetarja, duke vepruar në bazë të nenit 19(5) të Ligjit, i referoi Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Rregulloren e miratuar nga gjykatësit e Plenares.¹
4. Më të njëjtën ditë, në përputhje me nenin 33(3) të Ligjit, Kryetarja caktoi një panel të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e Rregullores, për të garantuar përputhshmërinë e Rregullores me Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.²

¹ Referim i Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Kryetarja, Nr. KSC-CC-PR-2017-01, 27 mars 2017.

² Vendim për caktimin e gjykatësve në një panel të Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara, Kryetarja, Nr. KSC-CC-PR-2017-01, 27 mars 2017.

5. Më 30 mars 2017, duke u bazuar në nenin 3(8)(c) të Ligjit, Kryetarja e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese bëri kërkesë për ndryshim të vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pranues.³

II. LIGJI PËRKATËS

6. Në nenin 3(6) të Ligjit thuhet se “Dhomat e Specializuara kanë një seli në Kosovë. Siç përcaktohet me anë të një marrëveshjeje ndërkombëtare me shtetin pranues, Dhomat e Specializuara po ashtu kanë seli edhe në shtetin pranues jashtë Kosovës [...]”.

7. Në nenin 3 të Marrëveshjes me Shtetin Pranues thuhet se “Institucioni Gjyqësor i Specializuar i Zhvendosur i Kosovës ka seli në shtetin pranues”.

8. Neni 3(8)(c) i Ligjit autorizon Kryetarin e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese që, për arsye të administrimit të duhur të drejtësisë dhe të sigurisë, sipas gjykimit të vet të kërkojë ndryshim të vendit të zhvillimit të procedurës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në shtetin pranues, në mënyrë që Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese të mblidhet, të shqyrtojë e të marrë dorëzime e parashtrime në selinë e Dhomave të Specializuara, në shtetin pranues.

9. Në nenin 3(8)(d) të Ligjit thuhet se në rast të një kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pranues, Kryetari nxjerr një vendim administrativ për ndërrimin e vendit të zhvillimit të procedurës, ose një pjese apo faze të saj, në shtetin pranues dhe urdhëron të gjithë hapat e nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi.

III. VENDI I ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS

³ Memorandum, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, Nr. KSC-CC-2017-02, 30 mars 2017.

10. Në përputhje me nenin 3(8)(c) të Ligjit, është kërkuar një ndryshim i vendit në lidhje me procedurën konkrete të shqyrtimit të Rregullores në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

11. Kryetarja vëren se administrimi i duhur i drejtësisë kërkon që vendi i zhvillimit të kësaj procedure të jetë në shtetin pranues, për të garantuar zhvillimin efikas, efektiv dhe të sigurt të procedurës.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, KRYETARJA NË VIJIM

cakton vendin e zhvillimit të procedurës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave, në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit, në shtetin pranues, në mënyrë që Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese të mbliidhet, të shqyrtojë e të marrë dorëzime e parashtrime në selinë e Dhomave të Specializuara, në shtetin pranues; dhe

kërkon prej Administratores që të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi.

/nënshkrim/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare

E mërkurë, 12 prill 2017

Në Hagë, Holandë